Kronikë

# Tiranë/ Mbante armë dhe lëvizte me taksi për të shmangur kontrollet e Policisë, pranga 23-vjeçarit (EMRI +VIDEO)

*Policia e Tiranës ndaloi një taksi me të cilën kishte marrë informacione se lëvizte një person i armatosur.*




**Redaksia**
28 Korrik, 10:31 | **Përditesimi: 28 Korrik, 10:42**

Share

**Tiranë-** Policia e Tiranës ndaloi një taksi me të cilën kishte marrë informacione se lëvizte një person i armatosur.

Paulo Gjini, 23-vjeç me banim në Lezhë, u arrestua në Rrugën e Dibrës, pasi iu gjet me vete, në çantë, një pistoletë me municion.

Në gjendje të lirë po hetohet kushëriri i tij 24 vjeçar që ndodhej me të në taksi, i dyshuar për moskallëzim krimi.



LEXO EDHE:
**SPAK mori Veliajn të pandehur, avokatët kërkojnë zgjatje afati për njohjen me dosjen hetimore**

Sipas policisë, i riu lezhjan, lëvizte i armatosur me taksi për të shmangur kontrollet e Policisë.

**Njoftimi i policisë:**

*Si rezultat i administrimit të menjëhershëm të informacioneve të siguruara në rrugë operative, se një shtetas që levizte me taksi, posedonte 1 armë zjarri, shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 4 finalizuan operacionin "Destinacioni".*

*Gjatë operacionit, u ndalua në Rrugën e Dibrës, taksia me të cilën lëviznin shtetasi P. Gj., 23 vjeç dhe kushëriri i tij, shtetasi Xh. Gj., 24 vjeç, të dy banues në Lezhë. Nga kontrollet, në çantën e 23-vjeçarit, u gjet 1 armë zjarri pistoletë me municion.*

*Në përfundim të veprimeve procedurale në lidhje me këtë rast, shtetasi P. Gj. u arrestua për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", ndërsa 24-vjeçari u procedua në gjendje të lirë, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".*

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

**TAG:** Tirane | arme zjarri | Paulo Gjini

Komento

**Komente**

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 27 Korrik, 08:41
**Si mendoni se po menaxhohet situata me zjarret?**

Mirë | Keq | Nuk e di

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

## Lajme të tjera



Aksioni për lirimin e hapësirave publike në Tiranë, Rama: Eh mër çuna vap e modhe e di, por duhet ajrosur lagjja apo jo?
27 Korrik, 20:47



FOTOT/ Tirana çlirohet nga zaptimet, Rama: Aksioni do vijojë sa të jetë nevoja
27 Korrik, 15:46



Bashkia e Tiranës u bën thirrje qytetarëve: Raportoni zaptimet e hapësirave publike në 'Tirana Ime'
27 Korrik, 12:58




Tiranë/ Arrestohet 63-vjeçari që shkaktoi djegien e 600 hektarëve në Parkun Kombëtar të Dajtit (EMRI+VIDEO)
27 Korrik, 11:31



Ekskluzive/ Report Tv në bordin e helikopterit "Cougar" gjatë luftës me flakët në Delvinë! Beteja e padukshme e pilotëve të forcave ajrore (VIDEO)
Sokol Dema
26 Korrik, 15:00



Bie zjarr edhe në Bërzhitë të Tiranës, ndërhyn helikopteri nga ajri
26 Korrik, 14:25




Ishte kthyer në makthin e qytetarëve dhe bizneseve, arrestohet hajduti 'serial' në Tiranë! I sekuestrohen 600 mijë lekë dhe 8200 euro
26 Korrik, 14:20



Tiranë/ U dëmtua nga zjarri i rënë një ditë më parë, vendoset në funksion të plotë nënstacioni elektrik në Ibë
26 Korrik, 12:33



Furnizonin me kokainë shpërndarësit në Tufinë, Kinostudio e Fresk, 2 të arrestuar në Tiranë (EMRAT+VIDEO)
26 Korrik, 11:58



U dogj gjatë përpjekjeve për të shuar zjarrin në Delvinë, transportohet në Tiranë 42-vjeçari
26 Korrik, 09:24



Ben Andoni: Më shumë interesohet Thaçi për Tiranën, sesa Kurti për të
Ben Andoni
25 Korrik, 20:34



Tiranë/ Zjarr i fuqishëm në nënstacionin në Ibë, shuhet falë ndërhyrjes në kohë të zjarrfikësve! OSSH: Po punojmë për rikthimin e energjisë elektrike në 4 zona
25 Korrik, 18:43



© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje